

## INFORMATË PËR SHTYP

### **Gjykata e apelit e Hamburgut ia ndalon NDR-së raportimin proklamues**

#### **Akuzat ndaj Ecolog AG janë të pabaza**

Gjykata e apelit e Hamburgut ka lëshuar vendim të shpejtë kundër Norddeutschen Rudfunk-ut (NDR-së). Parashtruesi i kërkesës është Ecolog AG, një kompani udhëheqëse për sa u përket shërbimeve logjistike për forcat ushtarake në rajonet e krizës. Arsyeja e parashtrimit të kërkesës bazohej në shprehjen e pabazë të dyshimit nga ana e NDR-së në programin e saj të radios, në publikimet e saj në internet (para së gjithash, në tagesschau.de) dhe në një informatë për shtyp. Me këtë rast NDR-ja e ka shprehur dyshimin, se firma Ecolog AG kontratat për misionin ISAF në Afganistan t'i ketë keqpërdorur për veprime ilegale. Në këtë kontekst është përmendur edhe "kontrabanda e drogës". Më tej NDR-ja ka raportuar edhe për aludime të mundshme sa i përket veprimtarisë në sferën e "kriminalitetit të organizuar" nga ana e familjes së themeluesit të Ecolog-ut.

"Akuzat që të gjitha janë të pabaza dhe pa asnjë pikë substance", sqaron Thomas Wachowitz, antar i bordit të firmës Ecolog AG. "Ne ia kemi ofruar më shumë herë mundësinë NDR-së, për të hedhur një vështrim gjithëpërfshirës në veprimtarinë tonë dhe në strukturat e sipërmarrjes, që ajo të ketë një pasqyrë sa më të qartë sa i përket ecurisë interne dhe eksterne të sipërmarrjes. Kjo gjë nuk është shfrytëzuar. Për më tepër, NDR-ja ka përhapur akuza të pabaza dhe kompanisë tonë i ka shkaktuar një dëm të madh të reputacionit."

Në mënyrë konsekuente ia ka ndaluar tani Gjykata e apelit e Hamburgut (Numri i dosjes 234 O 94 10, vendimi i datës 5 mars 2010) NDR-së përsëritjen e shprehjeve përkatëse të dyshimit ndaj firmës Ecolog AG. Më tej në këtë vendim të shpejtë NDR-së gjithashtu i ndalohej, që ta përsërisë dyshimin e shprehur ndaj familjes së themeluesit të kompanisë, se gjoja kjo qenka e pleksur në "kriminalitetin e organizuar". "Ne gëzohemi, që besimi ynë në shtetin ligjor është vërtetuar dhe që Gjykata e apelit e Hamburgut ia ka ndaluar NDR-së këto shprehje të dyshimit", është shprehur Wachowitz.

NDR-së tashmë në një vendim të mëhershëm, të lëshuar nga Gjykata e apelit e Kelnit, i është ndaluar të pohojë, se Ecolog-u deri në vitin 2007 paska marrë projekte nga Armata Federale Gjermane (Bundesver) pa u shpallur paraprakisht asnjë konkurs. "Pas vendimit të sotëm të Gjykatës së apelit të Hamburgut ne do të ndërmarrim hapa konsekuentë për sanimin e dëmit, të shkaktuar si rrjedhojë e

#### **Ecolog AG Germany**

In der Steele 14  
D-40599 Düsseldorf  
Postfach 160255  
40565 Düsseldorf

Phone +49 (0) 211 688 750 0  
Fax +49 (0) 211 688 750 199  
info@ecolog-international.com  
www.ecolog-international.com

Vorstand: Thomas Wachowitz, Samir Izairi, John Loeffen · Aufsichtsratsvorsitzender: Nazif Destani  
USt-ID Nr. DE 22 67 94 722 · StNr. 106 5770 1637 · Gerichtsstand: Amtsgericht Düsseldorf · HRB 5249;



raportimit të NDR-së dhe kundër NDR-së do të ngremë padi për zhdëmtim”, sqaron më tej Wachowitz. Krahas një padie të këtillë në Gjermani, Ecolog AG e shqyrton mundësinë e ngritjes së padive për zhdëmtim në vendndodhjet tjera të kompanisë, ku është cenuar imazhi i kompanisë me anë të raportimeve të pavërteta të NDR-së, madje gjithsesi edhe në SHBA.

Dyseldorf, më 5 mars 2010

Ecolog PR Office

Për më shumë info ju lutem na kontaktoni:  
[press@ecolog-international.com](mailto:press@ecolog-international.com)